

Në bazë të nenit 170 paragrafi (1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorëve (*) (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 236/22) dhe në bazë të pjesës III. Masat dhe Aktivitetet e Planifikuara për Realizimin e të Drejtave të Konsumatorëve, si dhe këshillimin, edukimin dhe informimin e konsumatorëve pika 1, Qëllimi 3 dhe nënpika 1.6 nga Programit për Mbrojtjen e Konsumatorëve për vitin 2024 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 32/ 24), Ministria e Ekonomisë dhe Punës publikon:

THIRRJE PUBLIKE

për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e programit (projekti) të shoqatave të konsumatorëve

1. Lënda

Ndarja e mjeteve financiare për realizimin e programit (projekti) që do të zbatohet nga shoqatat e konsumatorëve.

2. Qëllimi dhe përshkrimi i mbështetjes financiare

Sigurimi i mbështetjes financiare për OJQ-të për mbrojtjen e konsumatorëve për sigurimin e informacioneve dhe ndihmës për konsumatorët.

3. Shuma e mbështetjes financiare

Me këtë mbështetje financiare, Ministria e Ekonomisë dhe Punës ndan mjete financiare për realizimin e programit (projektit) për mbrojtjen e konsumatorëve në vlerë prej 300.000,00 deri në 500.000,00 denarë në përputhje me propozimet e dorëzuara për programet (projektet) për mbrojtjen e konsumatorëve deri në shterrimin e mjeteve financiare të parashikuara për këtë thirrje, për organizatat joqeveritare për mbrojtjen e konsumatorëve për sigurimin e informacioneve dhe ndihmës për konsumatorët.

4. Aktivitetet e pranueshme për financim:

Mbështetja financiare e shoqatave për mbrojtjen e konsumatorëve i referohet aktiviteteve të mëposhtme:

- ngritjen e ndërgjegjësimit dhe kulturës së konsumatorëve;
- informimin dhe këshillimin e konsumatorëve në kuadër të këshillave për mbrojtjen e konsumatorëve të formuar nga komunat, përkatësisht Qyteti i Shkupit, përkatësisht organizatat joqeveritare për mbrojtjen e konsumatorëve;
- këshilla ligjore për konsumatorët;

- fushata mediatike;
- dorëzimin e mendimeve dhe iniciativave për rregullimin plotësues të e rregullave në fushën e mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve;
- mbështetje konsultative të këshillave për mbrojtjen e konsumatorëve të themeluara nga komunat, përkatësisht qyteti i Shkupit;
- mbështetje financiare për shoqatat për mbrojtjen e konsumatorëve, gjegjësisht organizatat joqeveritare për mbrojtjen e konsumatorëve për anëtarësinë në Organizatën Evropiane të Konsumatorëve - BEUC dhe Organizatën Botërore të Konsumatorëve - Consumers International dhe
- aktivitete të tjera sipas Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorëve (*).

5. Veprimtaritë që nuk janë të volitshme për financim:

- Organizimi i ngjarjeve dhe festimeve luksoze:
- Përfshirë festat, darkat dhe eventet e tjera të ngjashme që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve.
- Veprimtaritë politike dhe fetare:
- Veprimtaritë që promovojnë parti politike apo organizata fetare dhe që nuk lidhen me qëllimet e mbrojtjes së konsumatorëve.
- Veprimtaritë tregtare me qëllim përfitimi:
- Përfshin aktivitete që synojnë kryesisht gjenerimin e fitimit në vend të sigurimit të mbrojtjes ose mbështetjes së konsumatorëve.
- Prokurimi i pajisjeve personale për të punësuarit:

- Përfshirë blerjen e pajisjeve të tilla si laptopë, telefona celularë ose pajisje të tjera që do të përdoren për qëllime personale.

- Udhëtime dhe qëndrime pa qëllim të arsyetuar:

- Udhëtime që nuk lidhen drejtpërdrejt me qëllimet e projektit apo aktivitetet e organizatës.
- Financimi i aktiviteteve që tashmë janë financuar nga burime të tjera:

- Veprimtaritë që financohen pjesërisht ose plotësisht nga programe ose fonde të tjera.

- Rinovimi i ambienteve që nuk lidhen drejtpërdrejt me projektin:
- Rinovimi ose përmirësimi i ambienteve të zyrave që nuk janë thelbësore për zbatimin e projektit.
- Aktivitetet që lidhen me trajnimin personal dhe zhvillimin e të punësuarve:
- Përfshirë trajnimet personale, zhvillim të aftësive ose kurse edukative, që nuk lidhen drejtpërdrejt me qëllimet e organizatës për mbrojtjen e konsumatorëve.
- Dhurata dhe çmime:
- Përfshirë dhënien e dhuratave ose çmimeve që nuk janë pjesë e aktiviteteve zyrtare të ngritjes së ndërgjegjësimit konsumator ose informimit të konsumatorëve.

- Aktivitetet e marketingut me qëllim komercial:
- Aktivitetet e marketingut që kanë për qëllim kryesisht promovimin e produkteve ose shërbimeve të organizatës që nuk lidhen me mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve.

Këto aktivitete nuk janë të volitshme për financim sepse nuk kontribuojnë drejtpërdrejt në qëllimet e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të konsumatorëve në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorëve.

6. Shpenzimet që janë të pranueshme për financim:

- Paga bruto e të punësuarve:
- Paga bruto për të punësuarit tek aplikuesi dhe anëtarët e organizatës që do të angazhohen në projekt.
- Shumat e pagave bruto të të punësuarve të angazhuar në projekt duhet të korrespondojnë me praktikën e aplikuesit para fillimit të projektit, të reduktuara me shumën e subvencionit të mundshëm shtetëror të marrë në bazë të pagës.

- Blerja dhe/ose marrja me qira e pajisjeve dhe materialeve harxhuese për funksionimin e qendrës së këshillimit ligjor

- Angazhimi i konsulentëve për nevoja që lidhen drejtpërdrejt me rezultatet e pritshme të projektit

- ekspertë të lidhur me përpilimin e materialeve për ngritjen e ndërgjegjes së konsumatorëve për të drejtat e tyre.

Mbështetje në zyra dhe biznes:

" Qira e ambienteve për zyra.

" Shpenzime të përgjithshme.

Vërejtje:

Vetëm shpenzimet e e bëra për aktivitetet e zbatuara gjatë kohëzgjatjes së projektit, e të cilat janë në përputhje me buxhetin e miratuar të projektit dhe rregullat dhe procedurat e përshkruara në thirrje, janë të volitshme për financim

7. Shpenzimet që nuk janë të voltitshme për financim

- Shtesat në paga të definuara sipas Ligjit për Marrëdhëniet e Punës.

- Shlyerja e kamatës ose e borxhit ndaj një pale tjetër.

- Shpenzimet dhe rezervimet për humbjet ose borxhet në të kaluarën dhe borxhet eventuale në të ardhmen.

- Humbjet dhe gjobat në kursin e këmbimit.

- Shpenzimet për argëtim dhe gastronomi.

- Shpenzimet e rekrutimit të stafit (Shpenzimet e reklamave, komisionet e agjencive të punësimit, shpenzimet e përzgjedhjes së kandidatëve, etj.) dhe shpenzimet e shpërnguljes.

- Blerja e tokës ose ndërtesave, duke përfshirë rinovimin.

- Pagesa me para të gatshme nga llogaria dedikuese e projektit.

- Shpenzimet për shërbimet e konsulencës të siguruar nga personat e punësuar në organizatë/anëtar të organizatës.
- Qiraja e hapësirës afariste nga qiradhënës që merr pjesë në aktivitetet e projektit ose është person i lidhur me organizatën/anëtar të organizatës.
- Blerja e automjeteve
- Shpnezimet për realizimin e aktiviteteve që paraprakisht janë financuar nga burime të tjera.
- Shpenzime për blerjen e pajisjeve të përdorura.

Kjo listë mbulon kategoritë kryesore të shpenzimeve që nuk janë të volitshme për financim dhe mund të jetë e dobishme në hartimin e planeve financiare për organizatat për mbrojtjen e konsumatorëve.

8. MJETET NDAHEN NGA: Ministria e Ekonomisë dhe Punës, rr. juri Gagarin nr. 15, 1000 Shkup.

Vlera e përgjithshme e thirrjes publike është 2.000.000 denarë

9. TË DREJTË PËR PJESËMARRJE

Shoqatat e konsumatorëve që plotësojnë kriteret e mëposhtme kanë të drejtë të marrin pjesë në thirrje:

- marrja me aktivitete dhe projekte në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve;
- nuk kanë marrë fonde ose nuk kanë parashtruar kërkesë nga/në një organ tjetër të administratës shtetërore ose burime të tjera për qëllime dhe veprimtari të njëjta ose të ngjashme për çka aplikojnë.

10. MËNYRA E APLIKIMIT NË THIRRJE PUBLIKE

Për pjesëmarrje në Thirrjen Publike - aplikuesit drejtuar Ministrisë së Ekonomisë dhe Punës duhet të dorëzojnë:

- Kërkesa për ndarjen e mjeteve për realizimin e programit (projektit) (në tekstin e mëtejme: Kërkesa për ndarjen e mjeteve për realizimin e programit (projektit) të shoqatave të konsumatorëve) (formularë të Kërkesës për ndarjen e mjeteve për realizimin e programit (projektit) të shoqatave të konsumatorëve mund të sigurohet në faqen e internetit të Ministrisë www.economy.gov.mk ose në arkivin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Punës):

- Deklaratë e vulosur nga noteri (formulari i Deklaratës mund të merret nga uebfaqja e Ministrisë www.economy.gov.mk ose në arkivin e Ministrisë së Ekonomisë) me çka deklaron se: nuk kanë marrë mjete ose nuk kanë parashtruar aplikim nga / në një organ

tjetër të administratës shtetërore ose burime të tjera për dedikimin e njëjtë ose aktivitete për të cilat parashtrajnë aplikim.

11. PËRMBAJTJA E OFERTËS

Oferta duhet të përmbajë:

Në shtojcë të ofertës duhet të dorëzohen:

1. Gjendja aktuale dhe Vërtetim i veprimtarisë së regjistruar
2. Programi i punës në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve;
3. Deklaratë të vulosur nga noteri se merret me veprimtari dhe projekte në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve,

4. Deklaratë e vulosur nga noteri (formulari i Deklaratës mund të merret nga uebfaqja e Ministrisë www.economy.gov.mk ose në arkivin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Punës) me të cilën deklaron se: nuk kanë pranuar mjete ose kanë parashtruar kërkesë nga/në një organ tjetër të administratës shtetërore ose burime të tjera për të njëjtin dedikim dhe veprimtari për të cilat parashtrajnë kërkesë.

5. Lista e ekspertëve me arsim të lartë përgjegjës për zbatimin e projektit

12. KRITERE PËR PËRZGJEDHJE

KRITERE PËR PËRZGJEDHJE	БОДОВИ
1. Programi i ofruar (projekti)	30/100
1.1. A kryhet me aktivitetet e propozuara në projekt ndikim konkret në grupet e synuara?	10/30
1.2. A janë qartë të definuara nevojat e grupit të qëllimit dhe të njëjat a janë në mënyrë të rregullt të përfshirë në projekt?	10/30
1.3. A përfshihen në projekt indikatorë dhe matës objektivë? =	10/30
2. Relevancë	35/100
2.1. A ka aplikuesi përvojë në drejtimin e projekteve? (lista e projekteve të realizuara me të cilët drejtuesi ka udhëhequr ose ka marrë pjesë në programe të tjera)?	10/35
2.2. Materialet informative të lëshuara nga fusha e mbrojtjes së konsumatorëve (broshura, fletushka, buletinë dhe ngjajshëm)	15/35
2.3. Bashkëpunim me institucione të tjera, organizata dhe këshillë për mbrojtjen e konsumatorëve në nivel lokal dhe qendror	10/35
3. Struktura organizative dhe resurset	35/100

3.1. Të regjistruara si shoqata të qytetarëve me veprimtari bazike të mbrojtjes së konsumatorëve (aktvendim nga Regjistri Qendror i RMV)	10/35
3.2. A është aplikuesi anëtar i Organizatës Evropiane të Konsumatorëve-BEUC dhe Organizatës Botërore të Konsumatorëve - Consumers International	5/35
3.3. Selia dhe qendra e këshillimit për mbrojtjen e konsumatorëve të aplikuesit të projektit (pikëzimi do të bëhet në mënyrë të shkallëzuar, ku numri më i lartë i pikëve do t'i jepet aplikuesit, qendra e këshillimit të të cilit mbulon një numër më të vogël banorësh, ndërsa numri më i vogël i pikëve do t'i jepet aplikuesit, qendra e këshillimit të të cilit mbulon një numër më të madh banorësh	15/35
3.4. Profesionistët që do të angazhohen në zbatimin e programit (projektit) (biografia e punës së personave që do të angazhohen për realizimin e programit)	5/35

13.MËNYRA E DORËZIMIT TË OFERTAVE

Oferta dorëzohet në origjinal të vulosur dhe nënshkruar (çdo faqe) nga personi përgjegjës i ofertuesit.

Oferta mund të dorëzohet përmes postës në adresën: rr. "Jurij Gagarin" nr.15, Shkup, ose me dorëzim në arkivin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Punës, çdo ditë pune nga ora 9:00 deri në orën 16:00.

Oferta dhe dokumentacioni tjetër duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur në këndin e sipërm majtas të të cilit, duhet të shkruajë shenjë - "Mos hap" dhe titulli i kësaj thirrjeje. Në mes të zarfit duhet të shënohet adresa e saktë e Ministrisë së Ekonomisë dhe Punës. Zarfi nuk duhet të përmbajë asnjë shenjë që mund të identifikojë dërguesin - ofertuesin.

Afati i fundit për pranimit të ofertës është ora 16:00 më 20.09.2024.

Ofertat që nuk dorëzohen brenda afatit të caktuar nuk do të merren parasysh.

Përdoruesi i mjeteve të ndara të pakthyeshme, është i obliguar të paraqesë dëshmi për përdorimin e synuar të mjeteve.

Ministria e Ekonomisë dhe Punës rezervon të drejtën të monitorojë realizimin e projekteve, si dhe të kontrollojë shpenzimin e synuar të mjeteve.

Në rast të numrit të pamjaftueshëm të kërkesave të pranuar, Ministria do të publikojë njoftim për vazhdimin e thirrjes publike për dhjetë ditë në ueb faqen e Ministrisë: www.economy.gov.mk dhe në dy gazeta ditore.

Aplikuesve, të cilët kanë dorëzuar kërkesë dhe nuk plotësojnë kërkesat e pikës 9 të kësaj Thirrjeje Publike, dhe/ose nuk kanë dokumentacion të rregullt dhe të plotë, dhe/ose kanë

dhënë të dhëna të papërputhshme në kërkesë dhe në dokumentacionin e plotë, nuk mund t'u ndahen mjete dhe Komisioni i refuzon këto kërkesa si jo të plota

14. MËNYRA E ZBATIMIT TË THIRRJES PUBLIKE

Ministri i Ekonomisë dhe Punës do të formojë komision për zbatimin e Thirrjes Publike; Komisioni do të synojë të përcaktojë përmbushjen e kushteve për ndarjen e mjeteve nga pika 9 e kësaj Thirrje Publike.

Komisioni do të shqyrtojë kërkesat e pranuar të dorëzuara në përputhje me ditën e fundit të përcaktuar në këtë thirrje publike, së bashku me dokumentacionin e nevojshëm.

Vendimin për ndarjen e mjeteve e merr ministri me propozim të Komisionit, pas së cilës vijon nënshkrimi i Marrëveshjes me përdoruesin e mjeteve.

15. DATA, KOHA DHE VENDI I HAPJES SË OFERTAVE

Hapja publike e ofertave do të bëhet më datë 23.09.2024 në orën 10:00 në ambientet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Punës në katin e I-rë në sallën e mbledhjeve.

Të drejtë për pjesëmarrje në hapjen publike të ofertave kanë personat përgjegjës të ofertuesve ose përfaqësuesit e ofertuesve të cilët, për praninë e tyre, duhet të paraqesin autorizim me shkrim nga ofertuesi, drejtuar Komisionit të Ndarjes së Mjeteve.

tel: ++ 389 2 3093 512

++ 389 2 3093 537

faks: ++389 2 3084 901

Ministria e Ekonomisë dhe Punës